



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 19 Shkurt 2022

Nr: 88

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQATËS PËR KULTURË DEMOKRATIKE DHE
KOALICIONIT PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSITUCIONE TË
KONSOLIDUARA PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR KRYETAR
BASHKIE, TË DATËS 6 MARS 2022**

Sot, më datë 19.2.2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi kërkesën e:

KËRKUES: Shoqata për Kulturë Demokratike, me seli në Tiranë, Rruga “Ymer Kurti”
Ap.6, me përfaqësues zj. Gerta Meta;

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara, me seli
në Tiranë, Rruga “Ymer Kurti” Nd.4, Ap. 3, me përfaqësues z.Premto Gogo;

OBJEKTI: Kërkohet akreditimi si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për
kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.

BAZA LIGJORE: Nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë
29.12.2008,“Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe
Udhëzimit nr.2, datë 02.02.2021 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat
e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja,
organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, medieve dhe
subjektet zgjedhore”,



VËREN:

Shoqata për Kulturë Demokratike (SHKD) i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 16 (gjashtëmbëdhjetë) vëzhguesve afatshkurtër, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Shoqata për Kulturë Demokratike është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 46 (dyzetë e gjashtë) vëzhguesve afatgjatë, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe udhëzimin nr. 2, datë 2.2.2021 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

V E N D O S I:

1. Akreditimin si vëzhgues afatshkurtër për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 16 (gjashtëmbëdhjetë) përfaqësuesve të Shoqatës për Kulturë Demokratike, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Akreditimin si vëzhgues afatgjatë për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 46 (dyzetë e gjashtë) përfaqësuesve të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.



3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

